

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-158/13

Prishtinë,
19 mars 2014

Në procedure civile të:

E B
D SU ½ Hyrja e x
P

Ankuesi

kundër.

D N
Rr. H A, nr. 13
P/P

Pala përgjegjëse në ankesë/Pala përgjegjëse

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët Willem Brouwer, Kryetar i Kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur në ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/175/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA01099), të datës 22 tetor 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 19 mars 2014, mori këtë

AKGJYKIM

1. **Refuzohet si e pabazuar ankesa.**
2. **Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/175/2012, i datës 22 tetor 2012 (KPA 1099), për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA 1099.**

Përmbledhja e çështjeve procedurale:

1. Më 29 gusht 2007, pala ankuese ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar konfirmimin e së drejtës së tij pronësore ndaj një banese në Ulpianë A-7/4 në Prishtinë, me sipërfaqe prej 36.71 m² (në tekstin e mëtejshëm: banesa).
2. Kërkesa është kundërshtuar nga pala përgjegjëse në kërkesë D N.
3. KKPK-ja kishte vendosur që të hedhë poshtë kërkesën duke iu referuar nenit 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin. 03/L-079, me arsyetimin se një kërkesë për pronën e njëjtë ishte vendosur nga Drejtorati për Çështje Pronësore dhe Banesore me vendimin HPCC/D/226/2005/A&C më datën 22 tetor 2005 (në tekstin e mëtejshëm: vendimi i DÇPB-së).
4. Vendimi i ishte dorëzuar palës ankuese më 29 prill 2013.
5. Pala ankuese ka paraqitur ankesë në AKP kundër vendimit të KKPK-së më 27 maj 2013, që është brenda afatit prej 30 ditëve të përcaktuar me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronë e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale.

Përmbledhja e çështjeve faktike:

Kolegji i Apelit konkludon se vendimi i KKPK-ws wshtw i bazuar nw vwrтетim tw drejtw dhe twplotw tw gjendjes faktike gjw qw edhe palwt ne kontest nuk e kundwrshtojnw.

6. Ditunije Nelaj kishte jetuar në banesë që nga viti 1986 si qiramarrëse e Elektrokosova, kompani kjo që ishte punëdhënësi i saj në atë kohë.

7. Me vendimin për pushimin e marrëdhënies së punës të datës 23 nëntor 1990, D N ishte pushuar nga puna e saj në E që nga data 26 nëntor 1990. Si pasojë e kësaj, ajo edhe ishte dëbuar nga banesa.
8. Me vendimin e EPS-PE “E”, të pasuar nga një kontratë mbi qiranë të datës 28 nëntor 1993, i punësuari Ž M M (në tekstin e mëtejme: M) u bë shfrytëzues i banesës.
9. Milič përfundimisht u bë pronar i banesës sipas kontratës së shitblerjes të vërtetuar nga Gjykata Komunale e Prishtinës më 18 mars 1994.
10. Sipas kontratës për shitblerjen e banesës të datës 7 maj 2004, pala ankuese e kishte blerë banesën e M M.
11. Vendimi i DÇPB-së ishte marrë si vendimi grupor lidhur me disa kërkesa, ku mes tjerash kërkesa e D N ishte kontestuar nga M ndërsa kërkesa e Mishte kontestuar nga D.N. Të dy kërkesat kishin të bëjnë me banesën në fjalë.
12. Kwrkesa e D N ishte vendosur si e bazuar ndërsa kwrkesa e M ishte refuzuar.
13. Për më tepër, në paragrafin 6 të vendimit të DÇPB-së, në kombinim me paragrafin 7, ishte vendosur se kontrata e shitblerjes e lidhur ndërmjet M dhe palës ankuese E B ishte në kundërshtim me nenet 5.1 dhe 5.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60, prandaj ajo edhe ishte e pavlefshme
14. Milič dhe pala ankuese E B kishin paraqitur kërkesë për rishqyrtimin e vendimit të DÇPB-së. Palë përgjegjëse në kërkesë ishte D N.
15. Kjo kërkesë ishte refuzuar nga DÇPB-ja me vendimin grupor HPCC/REC/61/2006 të datës 31 mars 2006.

Arsyetim ligjor:

Qëndrimi i palëve

16. Pala ankuese kërkon konfirmimin e pronësisë së tij legjitime të banesës dhe që t'i mundësohet ushtrimi i kësaj të drejte.

Juridiksioni

17. Gjykata Supreme Ka juridiksion në këtë çështje.

Pranueshmëria

18. Ankesa e palës ankuese është e pranueshme.

Meritat

19. Pasi që vendimi i DÇPB-së i datës 22 tetor 2005, ishte konfirmuar me vendimin HPCC/REC/61/2006 të datës 31 mars 2006, vendimi i DÇPB-së është bërë i plotfuqishëm.
20. Neni 166 paragrafi paragrafi 2 i LPK-së, që zbatohet *mutatis mutandis*, sipas nenit 13.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, parasheh se **nuk** lejohet gjykim i ri ndërmjet palëve të njëjta për një çështje ligjore për të cilën ekziston vendimi i plotfuqishëm.
21. Pasi që lënda para DÇPB-së kishte të bënte me të njëjtën çështje – banesën, dhe pasi që ajo ishte ndërmjet palëve të njëjta, çështja është *res judicata*.
22. Se, siç pohon pala ankuese, ai asnjëherë nuk e kishte pranuar me shkrim vendimin HPCC/REC/61/2006 të datës 31 mars 2006, kjo nuk ndikon në plotfuqishmërinë e vendimit. Ky vendim është plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk është objekt shqyrtimi nga ndonjë organ tjetër gjyqësor apo administrativ në Kosovë.
23. Duke qenë në këtë mënyrë, KKKP-ja ka marrë vendim të drejtë mbi baza të drejta.
24. Të gjitha pretendimet e metutjeshme të palës ankuese kanë të bëjnë me vendimin e DÇPB-së dhe nuk ka nevojë për ndonjë shqyrtim të mëtejme nga Gjykata Supreme.

Konkludim

25. Çështje e lartpërmendur bëjnë Gjykatën Supreme që të nxjerrë konkludim se ankesa e palës ankuese duhet të refuzohet dhe vendimi i KKKP-së duhet të konfirmohet për sa i përket kërkesës së regjistruar me numrin KPA1099.
26. Nga sa u tha më lartë, sipas nenit 13.3 nën (c) të Rregullores së UNMIK 2006/50 e plotësuar me Ligjin 03/L-079, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Udhëzim juridik

27. Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjete të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Willem Brouwer, Kryetar i Kolegjit, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Elka Filcheva – Ermenkova, Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it